

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Emin Emimi – Drejtor Artistik ne Teatrin Kombetar te Kosoves, për kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 e koform nenit 6 pika 6 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë,nr. 03/L-151 e në bazë të nenit 73, 74 dhe nenit 198 al.1 pika 1 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 15.12.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Emin Emimi – Drejtor Artistik ne Teatrin Kombetar te Kosoves, për kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 e konform nenit 6 pika 6 Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë nr.03/L-151.

Procedura **pezullohet** konform nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit Mbi Kundervajtjet, pasi që nuk ka prova te mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtuesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit, parashtroi kërkesën me nr. 01/4102/10 të dt. 26.10.2011 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.Ne baze te kerkeses se parashtuar u iniciua procedura kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehurin i cili deklaroi se,me date 27.07.2011 eshte emeruar Drejtor artistik ne teatrin kombëtar te Kosoves mirpo asnjehere nuk ka qene i informuar per obligimin e deklarimit te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit dhe lidhur me kete propozon qe te ndegjohet ne cilësi te dëshmitarit Alban Berisha Udheheqes i Divizionit ne Ministrine e Kultures Rinise dhe Sportit .Per vërtetimin e gjendjes faktike ne cilësi te dëshmitarit u ndegjua edhe Alban Berisha ,i cili gjithashtu ka qene pike kontaktuese per Agjensine Kunder Korrupsionit,i cili deklaroi se eshte e vertete se nuk e ka informuar Drejtorin Artistik te Teatrit Kombetar Emin Emimi ,lidhur me obligimin e deklarimit te pasurise prane kësaj Agjensie,duke konsideruar se i njëjti nuk ka nje obligim te tille per faktin se nuk ka udhëhequr me asnjë njesi buxhetore.Me tutje shton se eshte e vertete se Agjensise i ka dorëzuar listen me emrat e zyrtareve te larte me date 11 .08.2011 ku ka figuruar edhe emri i Emin Emimit si zyrtar i larte publik ,mirpo me date 12.11.2011 i eshte drejtuar me nje shkrese Agjensise permes se ciles e ka njoftuar te njejten se përfshirja e Emin Emimit ne listen e zyrtareve te larte publike qe kane per obligim deklarimin e pasurise ,ka qene nje leshim i paqellimshem nga ana e tij si Udheheqes i Divizionit njeherit pike kontaktuese per agjensine.

Ne baze te te dhenave si ne kerkese ,deklarates se te pandehurit ,deklarates se Alban Berishes ne cilësi te dëshmitarit, shiqimit te shkresave te lendes e provave tjera te administruara gjate procedures ,ne mase te mjaftuar u vërtetua se nuk ka prova te mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre dhe koform nenit 198 al 1 pika 8 te LMK,se,e koform nenit 6 pika 6 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë nr.03/L-151, **PEZULLOHET** procedura kundervajtese pasi qe nuk ka prova se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre.

Me sa u cek me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrojë i pandehuri dhe parashtuesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes se këtij aktvendimi. Ankesa i parashtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtarja
Zajrete Muhaxheri

REPUBLICAN AGS WELSH PRISHTINE A KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË	
AGENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIA CHYTR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Emri	03-1729/2012
Proq.	
Dep.	
Nr. Hfaq.	
Broj-stranca	01
Nr. pages.	
Prishtine	